



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr. 12/02-1563
Dt: 02.02.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 10 të Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me pak se një vit, me datë 02.02.2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me pak se një vit, në këtë përbërje:
 1. Florent Koci – kryesues;
 2. Mirlinda Mullahasani – anëtare;
 3. Denis Efendija – anëtar.
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, duhet të ndërmer veprime konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe të Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
3. Mandati i komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me pak se një vit është dy (2) vite.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Të gjithë anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës

